



z. Hashim Thaçi,
Kryeministër
Qeveria e Republikës së Kosovës

Cc: z. Ahmet Shala,
Ministër
Ministria e Ekonomisë dhe Financave

z. Lutfi Zharku,
Ministër
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Prishtinë, 24 Nëntor 2009

I nderuar z. Kryeministër Thaçi,

Fillimisht Ju falënderojmë për gatishmerinë e vazhdueshme të përkrahni komunitetin e biznesit dhe proceset e rëndësishme ekonomike nëpër të cilat po kalon Kosova.

Përmes kësaj shkrese dëshirojmë të ju njoftojmë që në mbledhjen e mbajtur dje, Këshilli Drejtues i Odës Ekonomike të Kosovës ka miratuar propozimet, rekomandimet dhe kërkesat e mëposhtme përmes të cilave ju drejtohet institucioneve të Kosovës.

1. Të shqyrtohet seriozisht çështja e implementimit të CEFTA-s, përmes rritjes të aktivitetit diplomatik në drejtim të sigurimit të përfaqësimit të plotë të Kosovës në strukturat e CEFTA-s, sidomos kur e kemi parasysh që në vitin 2011 Kosova duhet të jetë kryesuese e radhës e CEFTA-s dhe në të njëjtën kohë të fuqizohen kapacitetet institucionale për implementim të CEFTA-s brenda MTI-së e cila deri tani është treguar neglizhente në trajtim të këtij problemi;
2. Kërkohej respektim i plotë i akteve ligjore dhe nënligjore mbi procedurat e importit të produkteve me prejardhje bimore dhe shtazore duke respektuar plotësisht licencat ekzistuese dhe kërkesat ligjore për certifikatat e origjinës dhe certifikatat sanitare dhe fitosanitare sidomos në raport me produktet me origjinë nga Serbia;

3. Të ndryshohet baza ligjore mbi investimet në harmoni me propozimet e mëhershme të OEK-ut;
4. Të shqyrtohen propozimet dhe kërkesat e OEK-ut në lidhje me themelimin e Këshillit Ekonomik Social (KES) në harmoni me vendimin e Qeverisë për themelimin e KES-it, duke respektuar kriteret e përcaktuara nga Qeveria;
5. Të shqyrtohet mundësia e heqjes së akcizës në importimin e kafes, në harmoni me politikat e vendeve të rajonit të cilat e kanë ndërruar një hap të tillë.

Ne besojmë fuqimisht që Qeveria e Kosovës do të jetë e gatshme t'i trajtojë këto çështje duke forcuar partneritetin me komunitetin e biznesit dhe ne të njëjtën kohë shprehim gatishmërinë që të forcojmë partneritetin me qëllim të krijimit të një mjedisi me të mirë për komunitetin e biznesit dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Me respekt,

Dr. Besim Beqaj
Kryetar